



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	40607 / 26
Nr. i fq. / Br. st.	- 3 -
Data: / Datum:	31.08.2026
VUSHTRRI - VUÇITRN	



KOMUNA VUSHTRRI

KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM ME ENERGJI ELEKTRIKE - KEDS SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION COMPANY - KEDS I S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU ELEKTRIČNOM ENERGIJOM - KEDS D.O.O.
KEDS - SH. A.
Nr. 13925 Dt. 07 SEP 2026
PRISHTINË VIII

MARRËVESHJE E MIRËKUPITIMIT PËR BASHKËFINANCIM

NË MES TË:

**KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM ME ENERGJI ELEKTRIKE - KEDS
SH.A**

DHE

KOMUNA E VUSHTRRIË

Kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit për Bashkëfinancim është lidhur në Prishtinë dhe hyn në fuqi më dt. 01 shtator 2026 në mes të:

A) Kompania Kosovare për Distribuum me Energji Elektrike Sh.A (në vijim: KEDS), kompani e inkuorporuar në mënyrë të rregullt sipas ligjeve të Kosovës, me nr. të regjistrimit të biznesit 810799364, Rr. Bulevardi "Bill Clinton", Nr.5, Komuna e Prishtinës, 10000, Republika e Kosovës përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Alpin Dogan,

dhe

B) Komunës së Vushtrrisë - përfaqësuar nga z. Ferit IDRIZI - Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, adresa: Rruga "Isa Boletini" nr.10. 42000 Vushtri, Republika e Kosovës.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për bashkëfinancimi është realizimi i disa projekteve në komunën e Vushtrrisë, konkretisht projektit me titull: **"Rrjeti i TM 10(20) kV dhe TU 04 kV – Vesekofc"** (Të bashkëngjitur gjeni projektin detal në Anex 1)

Neni 2 Vlera e projektit

Vlera e përgjithshme për realizimin e projekteve të cekur në nenin 1, të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për bashkëfinancim është në vlerë financiare: 241,937.42 €.

Neni 3 Mënyra e financimit

1. **Kompania Kosovare për Distribuid me Energji Elektrike Sh.A** (në vijim: KEDS) do të financojë në realizimin e këtij projekti të cekur në nenin 1 dhe 2, të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për bashkëfinancim në vlerë prej 123,388,084 €, ose 51.0% të vlerës së projektit, dhe do të mbështetë projektin me mjete financiare dhe kontributet që ajo posedon dhe do të angazhohet në vazhdimësi deri në përfundimin e projektit në tërësi.
2. **Komuna e Vushtrrisë**, do të financojë në këtë projekt, siç është cekur në nenin 1 dhe 2 të kësaj marrëveshjeje. Financimi nga komuna do të bëhet nga fondi për bashkëfinancim, në Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në shumën financiare prej 118,549,336 €, ose 49.00% të vlerës së projektit.

Neni 4 Obligimet e KEDS-it

1. **Kompania Kosovare për Distribuid me Energji Elektrike Sh.A** (në vijim: KEDS) do ta udhëheqë projektin të cekur në nenin 1, të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për bashkëfinancim dhe procedurat e tjera të nevojshme deri në përfundim të punimeve.
2. **Kompania Kosovare për Distribuid me Energji Elektrike Sh.A** cakton një person kontaktues lidhur me këtë projekt dhe informon Komunën.

Neni 5 Obligimet e Komunës

1. **Komuna e Vushtrrisë**, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje për bashkëfinancim me KEDS-SHA, merr për obligim që të bëjë zotimin e mjeteve dhe ta bëjë pagesën në llogarinë bankare të KEDS SHA në vlera financiare të ndara në dy këste dhe atë:
 - 1.1 kësti i parë, shuma prej **59.274,67 €**, jo më larg se 30 Shtator 2026.
 - 1.2 kësti i dytë, shuma prej **59.274,67 €**, jo më larg se 28 Shkurt 2027.

Neni 6 Raportimi me shkrim

Organin mbikëqyrës i caktuar nga Komuna në bashkëpunim me organin mbikëqyrës të caktuar nga KEDS, marrin për obligim që pas përfundimit të të gjitha procedurave dhe realizimit të projekteve të cekur në neni 1, të kësaj marrëveshjeje për bashkëfinancim të përgatitin **raport me shkrim**, në total për mjetet me bashkëfinancim për realizimin e projektit.

Neni 7
Ndryshimi i marrëveshjes me mirëkuptim

Me pëlqimin paraprak të **Kompanis Kosovare për Distributum me Energji Elektrike Sh.A** dhe **Komunës së Vushtrrisë**, kjo marrëveshje mundë të ndryshohet dhe plotësohet me aneks marrëveshje.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve eventuale

Të gjitha palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për bashkëfinancim dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për të vendos do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Ekonomike.

Neni 9
Numri i kopjeve

Kjo marrëveshje bashkëfinancim është e hartuar në 5 ekzemplarë identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

Neni 10

Palët në marrëveshje janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëfinancim të fillon të zbatohet menjëherë pas nënshkrimit nga të dy palët dhe të përfundoj në afat prej jo më larg se 24 muaj nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Prishtinë, 31/08/2026

P A L Ë T N Ë M A R R Ë V E S H J E

PËR: Kryetari i Komunës

Z. Ferit IDRIZI



PËR: KEDS

Z. Yusuf CIGDEM Drejtor i Investimeve

